

Në Prizren filloi punimet Konferenca ndërkombëtare me temën "Mbi papunësinë e të rinjve në Evropë"

Papunësia, plagë e shoqërisë evropiane

↑ "Secili vend që dëshiron të arrijë një zhvillim, duhet ta ketë parasysh punësimin e të rinjve, andaj le të shërbejë kjo konferencë si ngjarje ku do të ketë rezultate konkrete"

nexnat oaj
PRIZREN, 25 GUSHT

Që nga e premtdja e deri më 31 gusht 60 të rinj nga 13 shtete të Evropës, në Prizren po marrin pjesë në konferencën ndërkombëtare me temën "Mbi papunësinë e të rinjve në Evropë", konferencë kjo që po organizohet nga OJQ –ja SANDKORN, e cila nga viti 2002 funksionon edhe në Kosovë.

Pjesëmarrësit e kësaj konference do të mbajnë një videokonferencë me liderët e Parlamentit Evropian

Siç mësohet nga pjesëmarrësit e kësaj konference, më 29 gusht, pjesëmarrësit e kësaj konference drejtpërdrejt do të mbajnë një video konferencë me liderët e Parlamentit Evropian, për të diskutuar për rrugën më të mirë të mundshme të zbutjes së papunësisë së të rinjve. Në këtë videokonferencë të gjithë përfaqësuesit e 13 vendeve do t'i shprehin para parlamentarëve shqetësimet e vendeve të tyre, ndërsa më 31 gusht 13 përfaqësues të kësaj konference do të priten në Vjenë nga Ministria i Mbrojtjes, z. Norbert Dorabosz.

Si përfundim i kësaj konference pjesëmarrësit më 30 gusht do ta nxjerrin një rezolutë, të cilën do t'ia dorëzojnë Parlamentit Evropian si dhe do ta nënshkruajnë një peticion në përkrahje të të rinjve që kërkojnë punë.

Sipas Arben Fondaj, koordinator i OJQ-së SANDKORN, në Kosovë: "Qëllimi i kësaj konference është shkëmbimi i eksperiencave, rruga dhe mënyra më e mirë deri te punësimi i të rinjve, hapja e CV-ive, gjetja e zgjidhjes së punësim-it dhe zvogëlimi i papunësisë në Evropë e në veçanti në Evropën Juglindore".

Sipas z. Fondaj, organizimi i kësaj konference ndërkombëtare në Kosovë për ne është një shans më shumë për t'i treguar të rinjve të Evropës se Kosova nuk është vend i paragjyqimeve, por është vend që e meriton të zë vendin e vet në Evropë sa më parë.

Në ditën e parë të fillimit të kësaj konference ndërkombëtare, pjesëmarrësit janë vendosur në ambientet e Gjimnazit "Loyola" dhe është shpërndarë programi i punës për konferencën deri më 31 gusht. Në ditën e dytë pjesëmarrësit të ndarë në tri grupe kanë filluar shqyrtimin e temave siç është shqyrtimi i standardeve në mes shteteve, shoqëria dhe nivelet ekonomike në vendet evropiane.

Sipas pjesëmarrësve, tema qendrore e kësaj konference është një rast i mirë që vendet e Evropës të njihen më për së afërmi në mes vete dhe si rezultat i dis-



kutimeve mund të ndikojë edhe në krijimin e strategjive të reja për punësimin dhe zhvillimin e një vendi.

Maraketa Wanerova, përfaqësuese çeke, për gazetën tonë deklaroi se "në Republikën Çeke papunësia është vetëm 9%, andaj shqetësimet tona janë më të vogla në krahasim me vendet tjera, ku papunësia kap shifrën edhe mbi 50 %, por ne në këtë konferencë do t'i shkëmbejmë përvojat dhe rrugët më të lehta për të ardhur deri te punësimi i të rinjve". Mendoj se mënyra e punësimit të të rinjve në vendin tonë do t'u ndihmojë të rinjve të vendeve tjera, përfundon ajo, duke përgëzuar punimet e kësaj konference.

Nikolina Shkoro, përfaqësuese nga Serbia, fillimisht i deklaroi gazetës sonë se: "Kur jam nisur për të marrë pjesë në këtë konferencë jam nisur me paragjyqime për Kosovën, por me të arritur këtu u binda se Kosova është si çdo vend tjetër i botës së civilizuar. Nikolina, në vazhdim, në lidhje me temën e kësaj konference deklaroi se problemi i papunësisë që ballafaqohen të rinjtë është se: "Në Serbi punësimi është i mundshëm

vetem nepermjet rrugeve te korrupsionit e jo në bazë të aftësive dhe nevojave. Andaj pjesa më e madhe e të rinjve në Serbi e në veçanti ata që po studiojnë nuk e shohin dritën e perspektivës në Serbi, por mendojnë se si të ikin nga Serbia dhe të studiojnë e të punojnë diku jashtë. Ndër ta jam edhe unë që nuk e shoh ardhmërinë dhe perspektivën time në Serbi, por planifikoj të shkoj jashtë".

Edhe Karin Helmerson, përfaqësuese e Suedisë, shpreson se shkëmbimi i përvojave të të rinjve dhe shpaloja e shqetësimeve do të jenë rezultat që do të ndikojnë në hartimin e politikave rreth punësimit të të rinjve. Vendet siç është Suedia, siç shprehet ajo, duhet t'i shkëmbejnë përvojat e veta në mënyrë që edhe Shqipëria apo Kosova ta kenë numrin e të papunëve 7.5 % sa e ka Suedia. "Papunësia është plagë e shoqërisë evropiane, që do zgjidhje të ngutshme dhe të qëndrueshme", – përfundon Karin Helmerson.

Ulrih Raab, përfaqësues nga Austria, shprehet për gazetën tonë se: "Problemi i papunësisë së të rinjve është një kapitull në vete që meriton një vëmendje më të madhe seç po ndodh". Ai në vazhdim tha se si i ri pret që nga

Çfarë mund të presin të rinjtë në të ardhmen në lidhje me punësimin e tyre

Sipas organizatorëve të kësaj konference, të rinjtë pjesëmarrës janë nga këto shtete: Austria, Shqipëria, Republika Çeke, Kroacia, Hungaria, Irlanda, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Holanda, Suedia, Serbia dhe Sllovakia. Gjatë kësaj konference të rinjtë e Evropës në tri grupe do të diskutojnë për problemet më parësore që kanë të rinjtë për zbutjen e papunësisë.

Në grupin e parë punës të rinjtë e 13 vendeve të Evropës do të diskutojnë ndarjen e përvojave, në grupin e dytë për shqetësimet e të rinjve rreth punësimit dhe në grupin e tretë çfarë mund të presin të rinjtë në të ardhmen në lidhje me punësimin e tyre.

kjo konferencë që me rezultate dhe kërkesa konkrete të informohen liderët politikë në mënyrë që të marrin hapa konkretë në uljen e papunësisë së të rinjve. Secili vend që dëshiron të arrijë një zhvillim, duhet ta ketë parasysh punësimin e të rinjve, andaj le të shërbejë kjo konferencë si ngjarje ku do të ketë rezultate konkrete".

Sipas koordinatorit të kësaj konference, pritet që pjesëmarrësve t'u drejtohen edhe strukturat udhëheqëse të vendit, por sipas Arben Fondaj, pos Enver Hoxhës, që e ka konfirmuar pjesëmarrjen, përfaqësuesit e institucioneve tjera nuk kanë konfirmuar pjesëmarrjen e tyre për t'u drejtuar të rinjve të Evropës.

Konferenca i vazhdon punimet deri më 31 gusht.

